

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
“ENERGY FOOD” SHPK**

---

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME  
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"ENERGY FOOD" SHPK**

**KREU I  
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1  
EMRI I SHOQËRISE**

Sot, në Tirane më date 29/08 2023 ne të nënshkruarit :

Z. **Aldorian DHIMO**, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan, Shqipëri, më datë 19.12.1988, banues në Tiranë, Shqipëri, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 033874210 dhe me nr. personal **I81219043K**.

Z. **Klodian DEMIRAJ**, shtetas shqiptar, lindur në Lac, Shqipëri, më datë 23.08.1982, banues në Tiranë, Shqipëri, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 035089177 dhe me nr. personal **I20823066J**.

Z. **Skerdi DAMINI**, shtetas shqiptar, lindur në Fier, Shqipëri, më datë 09.02.1996, banues në Tiranë, Shqipëri, identifikuar nga pasaporta me nr. BE5521682 dhe me nr. personal **J60209070A**.

Z. **Florenc METANI**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më datë **13.01.1984**, banues në Tiranë, Shqipëri, identifikuar nga pasaporta me nr. **BD1151372** dhe me nr. personal **I40113025M**.

themelojmë këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin

**"ENERGY FOOD" Shpk** (Më poshtë e quajtur "Shoqëria")

**NENI 2  
SELIA**

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesi, nr pasurie 5/262 +1 - N5ZK8270, vol 48 , fq 2 Tirane, prane shkolles Petronini Luarasi, Tiranë.

2.2 Ortaket mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Personat përgjegjes për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashte Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3  
KOHËZGJATJA**

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

**NENI 4  
OBJEKTI I SHOQËRISË**

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtronë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:  
**Objekti i veprimitarisë së shoqërisë është në fushën e Gastronomisë dhe produkteve ushqimore, import-eksport, pajisjesh, ndërtimtari, rikonstrukcion, marketing, trajnime, shërbime dhe çdo veprimtari tjeter që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.**

4.2 Për më tepër shoqëria mund të veproje si agjent/ndermjetes për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskrecionin e saj të vetëm mund të kontrakteje palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha sherbimeve te mesiperme.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryeje çdo aktivitet tjeter të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit te sherbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave.

4.4 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizoje drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë cdo lloj pjesemarrje në shoqëri të tjera shiptare apo të huaja, si edhe të hyje ne marrëdhene kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose te huaj.

## **KREU II TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE**

### **NENI 5 HUMBJET E SHOQËRISË**

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakëve. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakut.

### **NENI 6 KONTRIBUTI I SHOQËRISË**

Ortakët jep kontributin e në shoqëri në para apo në natyrë, sipas nenit mënyrave dhe afateve të përcaktuara në këtë statut.

Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkësën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjeter të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përhapej personave të paautorizuar do ti shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtarë të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment.

Gjatë ushtrimit të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpilen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj të përcaktuar në nenin 1.

## NENI 7

### ABUZIMI I ORTAKUT NDAJ SHOQËRISË

Ortaku i shoqërisë tregtare, mban përgjegjësi dhe përgjigjet personalisht, në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tij për veprimet ose mosveprimet vijuese:

- a) abuzon me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajton pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tij;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

## NENI 8

### NDALIMI I KONKURRENCËS

Ortakët nuk mund të mbajë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimitari në të njëtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ai nuk mund të mbajë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimitari në këtë sektor.

Ndalimi i përmendor më sipër mund të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga asambleja e përgjithshme me 51% të votave ose me vendim të ortakut të vetëm.

Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendor në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

Nëse ortaku shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a. ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b. të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c. të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.
- d. Si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund të kërkojë:
  1. të pranojë që transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
  2. t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
  3. t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

## NENI 9

### LARGIMI I ORTAKUT NGA SHOQËRIA DHE LIKUIDIMI

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

Administratori/ët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpérblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpérblimin e dëmit të pësuar.

## NENI 10

### PËRJASHTIMI I ORTAKUT

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasojë e një financimi, investimi, shtimi në kapital dhe detyrime të tjera të parashikuara në Statut apo nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e tij sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:

- me dashje apo me pakujdesi të rendë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- me dashje apo me pakujdesi të rendë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut
- me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kerkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpérblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpérblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngrëndaj tij padi për shpérblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kerkuar nga shoqëria.

## KREU III

### KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE

#### NENI 11

#### KAPITALI I SHOQËRISË

11.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë, i përbërë nga 4 (katër) kuota, i ndarë si më poshtë:

**Aldorian Dhimo** person fizik, zotëruesh i 1 (një) kuote me 25% (njëzetë e pesë përqind) dhe vlerë 25 Lekë.

**Klodian Demiraj** person fizik, zotëruesh i 1 (një) kuote me 25% (njëzetë e pesë përqind) dhe vlerë 25 Lekë.

**Skerdi Damini** person fizik, zotëruesh i 1 (një) kuote me 25% (njëzetë e pesë përqind) dhe vlerë 25 Lekë.

**Florenc Metani** person fizik, zotëruesh i 1 (një) kuote me 25% (njëzetë e pesë përqind) dhe vlerë 25 Lekë.

Derdhja e kapitalit do te kryhet pas regjistrimit te Shoqërisë në regjistrin tregtar, gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit të Shoqërisë.

#### NENI 12

#### TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

12.1 Transferimi i kuotave te kapitalit te Shoqerise mund te behet me shitje, trashegimi, ose me çdo menyre tjeter te parashikuar nga ligji.

12.2 Ne rast transferimi te kuotave tek persona te trete jashte Shoqerise, qofte me shitje qofte me dhurim, ortaku qe synon te transferoje kuotat duhet t'i komunikojë ortakeve te tjere vullnetin e tij me shkrim. Ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes te kuotave te ortakeve, me kushte te barabarta, dhe duhet ta ushtrojne kete te drejte brenda 30 diteve nga marrja e komunikimit te vullnetit te ortakut per te transferuar kuotat.

12.3 Vlera e kuotes qe transferohet do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga ortaket me marreveshje ose nga gjykata ne rast se ortaket nuk bien dakort.

### **NENI 13 KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTAT**

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

### **NENI 14 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me miratim të asamblesë së përgjithshme me vendim të marrë me  $\frac{3}{4}$  e votave.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vodosur kuotat suplementare të ortakëve.

Vendimi për zmadhimin e kapitalit regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të tij në QKR.

Asambleja e përgjithshme, vodos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

### **NENI 15 FONDET REZERVË**

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike.

Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimitarisë së saj.

### **NENI 16 BILANCI DHE PLANI FINANCIAR**

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vodosura në Republikën e Shqipërisë.

Plani finanziar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit. Shoqëria mban libra kontabël, harton e publikon të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

### **NENI 17 SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë në raport pjesmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë.

### **NENI 18 KUFIZIMI I SHPËRNDARJEVE TË FITIMEVE**

Shoqëria mund të japë fitimin ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendift nëse:

1. aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
2. shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori lëshon certifikatën e aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividentëve përmbrush kërkesat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendifëve nuk i përmbrush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përrpara shoqërisë për kthimin e dividendifëve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendifë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendifëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

### **NENI 19 BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale

## KREU III ORGANET E SHOQËRISË

### NENI 20 ORGANET E SHOQERISE

Organet e Shoqerise jane:

- a) Asambleja e Pergjithshme;
- b) Administratoret.

### NENI 21 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

21.1 Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar ( $\frac{3}{4}$ ) e votave të pranishme në rastet e mëposhtme:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. shpërndarjen e fitimeve;
5. raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;

21.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshte (50+1) të votave të ortakëve pjesëmarrës rastet e mëposhtme:

1. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
2. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
3. Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
4. Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
5. Përcaktimin e shpërblimeve për administratoret, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
6. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
7. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
9. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
10. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Në rastin e shoqërisë me një ortak të vetëm të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm.

## NENI 22

Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në mbledhje të zakonshme të paktën një herë (1) herë në vit.

Asambleja është e detyruar dhe me çdo kusht të mblidhet në rastet e mëposhtme:

1. Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
2. Shoqëria propozon të shesë apo të blejë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo ortaku të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Në rastet e parashikuara në pikën 1 dhe 3 më sipër, përpara Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur. Në këto raste Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## NENI 23

### THIRRJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, dhe duhet t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## NENI 24

### KUORUMI DHE VENDIMMARRJA

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, kanë mundësinë e pjesëmarres në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

## NENI 25

### PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbal duhet të përbajë datën e vandin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbal i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

## NENI 26

### HETIMET E POSAÇME

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit në të kundërt brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

E drejta për të kerkuar hetim të posaçëm, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë ti kërkojë Gjykatës kompetente shfuqizimin e vendimeve të parregullta të administratorit të shoqërisë, kur këto përbëjnë shkelje të ligjit apo statutit. Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme apo secili kreditor i shoqërisë mund ti kërkojë asamblesë së Përgjithshme shfuqizimin si më sipër, ose ata mund të procedojnë vetë përpara gjykatës brenda 30 ditëve nga refuzimi I asamblesë për ngritjen e padisë. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar. Procedurat përpara gjykatës ndiqen nga një përfaqësues I posaçëm I shoqërisë I emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Kreditorët apo ortakët e sipërpërmendur kanë të drejtë të kërkojnë përpara gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit kur ka dyshime në lidhje me të përfaqësimin e tij jo në interesin më të mirë të shoqërisë.

Rastet e hetimeve të posaçme dhe shfuqizimit të vendimeve të parregullta do të rregullohen sipas neneve 91 dhe 92 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

**NENI 27  
ORTAKËT**

Ortakët e shoqërisë janë:

**Z. Aldorian DHIMO**, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan, Shqipëri, më datë 19.12.1988, banues në Tiranë, Shqipëri, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 033874210 dhe me nr. personal **I81219043K**.

**Z. Klodian DEMIRAJ**, shtetas shqiptar, lindur në Lac, Shqipëri, më datë 23.08.1982, banues në Tiranë, Shqipëri, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 035089177 dhe me nr. personal **I20823066J**.

**Z. Skerdi DAMINI**, shtetas shqiptar, lindur në Fier, Shqipëri, më datë 09.02.1996, banues në Tiranë, Shqipëri, identifikuar nga pasaporta me nr. BE5521682 dhe me nr. personal **J60209070A**.

**Z. Florenc METANI**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më datë **13.01.1984**, banues në Tiranë, Shqipëri, identifikuar nga pasaporta me nr. **BD1151372** dhe me nr. personal **I40113025M**.

## **NENI 28 ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME**

28.1 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te jashtezakonshme sa here eshte e nevojshme per marrjen e vendimeve ne interes te Shoqerise.

28.2 Vendimet qe kane te bejne me (por pa u kufizuar vetem ne to): ndryshimin e neneve te Statutit, zmadhimin ose zvogelinin e kapitalit, ndryshimin thelbesor te objektit te veprimitarise se Shoqerise, prishjen e Shoqerise konsiderohen vendime te jashtezakonshme.

28.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Pergjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave ne prani te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave.

28.4 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 12.3, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite. Ne rast se ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

## **NENI 29**

### **PJESEMARRJA, VOTIMI DHE PERFAQESIMI**

29.1 Secili ortak ka te drejten e pjesemarrjes dhe votimit ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak jane ne numer te barabarte me kuotat e zotruara prej tij.

29.2 Secili ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjet e Asamblese nga një ortak tjeter apo nga një person i trete me autorizim. Autorizimi mund te jepet vetem per një mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njetin rend dite.

## **NENI 30**

### **FINANCIMI I SHOQËRISË**

30.1 Organi i Administrimit te Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përvèc rasteve të zmadhimit te kapitalit ka të drejte të kërkoje nga ortaket e Shoqërisë fondet e nevojshme përritjen e objektivave të shoqërisë

30.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqeri do të jene me shperblim (interesa) apo pa shpërbirim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.

## KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 31 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

31.1 Shoqëria administrohet nga dy (2) Administratorë si më poshtë;

**Z.Andrea ZOGA**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më datë 28.04.1966, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. **037155854** dhe me nr. personal **G60428151G**.

**Z. Skerdi DAMINI**, shtetas shqiptar, lindur në Fier, Shqipëri, më datë 09.02.1996, banues në Tiranë, Shqipëri, identifikuar nga pasaporta me nr. BE5521682 dhe me nr. personal **J60209070A**,

të cilët emërohen nga ortakët e shoqerise për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Administratorët shkarkohen nga detyra, ne çdo kohe, me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme sipas Statutit te Shoqerise.

Administratorët veprojnë me kompetenca të kufizuara dhe/ose të pakufizuara sipas rastit, kompetencat dhe detyrat e tyre janë si më poshtë:

Kompetencat dhe detyrat e **Z. Andrea Zoga** :

- a) Nuk mund të lidh kontrata me palë të treta, me vlerë më të lartë se 1.000 Euro ose ekuivalenti i saj në monedhë të huaj. Pranimin e faturave të blerjes si dhe likujdimin dhe e tyre për një vlerë jo më shumë se 1.000 Euro ose ekuivalenti i saj në monedhe të huaj
- b) Nuk ka të drejtë për blerjen apo shitjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme;
- c) Kompetenca të pakufizuara në lidhje me pagesat për detyrimet tatimore dhe doganore pranë institucioneve të DPT dhe DPD.
- d) Kompetenca të pakufizuara në lidhje me pagesat e taksave, tatimeve dhe tarifave për dhe në ccd entitet publik.
- e) Kompetenca të kufizuara në lidhje me tërheqjet nga llogaria bankare.
- f) Kompetenca të kufizuara në lidhje me pagesat ndaj furnitorëve të cilat nuk duhet të janë më shumë se vlera e pranimit të faturave sipas pikës a) më sipër;
- g) Përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- h) Siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe rapporti i ecurisë së biznesit dhe cdo deklarim tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë sicc duhet;
- i) Siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspert kontabël të ccertifikuar dhe rapporti i llogaritarëve publik të ccertifikuar t'i vendoset në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme.

- j) Krijon një sitë paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajten e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- k) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

Kompetencat dhe detyrat e **Z. Skerdi Damini** :

- a) përgjegjës për fushatën e marketingut të kompanisë
  - b) përgjegjës për strategjinë e komunikimit me klientët
  - c) Nuk mund të lidh kontrata me palë të treta, me vlerë më të lartë se 1.000 Euro ose ekivalenti i saj në monedhë të huaj. Pranimin e faturave të blerjes si dhe likujdimin dhe e tyre për një vlerë jo më shumë se 1.000 Euro ose ekivalenti i saj në monedhë të huaj
  - d) Nuk ka të drejtë për blerjen apo shitjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme;
  - e) Kompetenca të pakufizuara në lidhje me pagesat për detyrimet tatimore dhe doganore pranë institucioneve të DPT dhe DPD.
  - f) Kompetenca të pakufizuara në lidhje me pagesat e taksave, tatimeve dhe tarifave për dhe në ccd entitet publik.
  - g) Kompetenca të kufizuara në lidhje me térheqjet nga llogaria bankare.
  - h) Kompetenca të kufizuara në lidhje me pagesat ndaj furnitorëve të cilat nuk duhet të jenë më shumë se vlera e pranimit të faturave sipas pikës a) më sipër;
- Administratorët e parë do t'i shtrojnë kompetencat e tyre të administrimit veccmas me përjashtim të veprimtarive të cilat kanë kompetenca të kufizuara dhe të cilat i ushtrojnë vetëm bashkërisht :
    - a) Lidhjen e kontratave me palë të tjera, me vlerë më të lartë se 1.000 Euro ose ekivalenti i saj në monedhë të huaj.
    - b) Pranimin e faturave të blerjes si dhe likujdimin dhe e tyre për një vlerë më të lartë se 1.000 Euro ose ekivalenti i saj në monedhë të huaj
    - c) Blerjen apo shitjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme;
    - d) Térheqjet nga llogaria bankare.

31.2 Administratori mund te ndërmarrë apo të kërkoi kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë pervec atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

## NENI 32 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

32.1 Shpërbimi i administratorit të shoqërisë do të percaktohet nga Ortaku i shoqerise.

**KREU V  
KONTROLLI KONTABËL I SHOQËRISË  
VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

**NENI 33  
KONTROLLI KONTABËL**

Kontrolli i jashtem kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ortaket do të emerojne një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kërkohet në baze të ligjit. Emërimi dhe caktimi i tyre do të kryhet në mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme me shumicë të thjeshtuar votash.

**NENI 34  
VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti

**NENI 35  
BILANCI DHE REZERVAT**

35.1 Me mbylljen e secilit vit finanziar Administratoret marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin finanziar të mbyllur ne mënyrë që ortaket të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

35.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividenteve që rezultojne si fitime sipas bilancit te miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

35.3 Ortaket në cdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

**KREU VI  
PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**NENI 36  
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

Kjo Shoqëri do të prishet në rast kur :

1. merr vendim Asambleja e Përgjithshme ;
2. hapen procedurat e falimentimit ;
3. nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar ;
4. merret një vendim gjykate ;
5. për arsyet tjerat, të parashikuara në statut ;

Në rastin e likuidimit te Shoqërisë do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

**NENI 37  
LIKUIDIMI I THJESHTËZUAR**

Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëni me punëmarrësit.

Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

**NENI 38  
NJOFTIMET**

38.1 Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nese ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre prane Administratoreve të Shoqërisë.

38.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit per nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

38.3 Në rastin kur një kuote zotërohet nga më shume se një përsone të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqesuesit të bashkëzotëruar të kuotës.

**KREU VII  
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 39  
LIGJI I ZBATUESHËM**

39.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelimi dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushën e shoqërive tregtare.

39.2 Ky Akt hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe, dhe pasi lexohet nga ortakët themelues të shoqërisë, firmoset si me poshte nga secili prej tyre.

**NENI 40**

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.


**NENI 41**

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 42**

Ky Statut hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesve, të cilët e nënshkruan pa vërejtje.


**ALDORIAN DHIMO**



**KLODIAN DEMIRAJ**



**SKERDI DAMINI**



**FLORENC METANI**

